



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR FURNIZIM

*KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë; dhe*

*NTSH "EJONA" -nga Peja, të cilën e përfaqëson, z. Hysni Prelvukaj, me Nr. Rexh. Biznesi, 810089913 (në vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:*

### TITULLI I KONTRATËS:

#### PAISJA E OBJEKTIT KOMUNAL ME LIFT AUTOMATIK

Nr. I prokurimit	633-19-607-1-2-1/ C199
Nr. I brendshëm	633 / 019 / 011 / 121

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

#### PAISJA E OBJEKTIT KOMUNAL ME LIFT AUTOMATIK

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total sipas kësajë kontrate është: 24.824,84 € dhe me fjalë:  
/Njëzetekatërmijëetëçindnjëzetekatëreuro/ 84/100

2.2. Oferta financiare e kontraktorit e datës: 18.03.19 është pjesë integrale e kontratës dhe bazë për pagesën e kontratës.

2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.5 Të gjitha pagesat kontraktorit do të behën pas perfundimit të furnizimeve dhe punëve që janë object I kësajë kontrate dhe specifikimeve të detyrueshme teknike të parashtruara në dokumentet e dosjës së tenderit.

### **Neni 3 Afati I kryrjes se punimeve**

3.1 Afati i kryerjës të gjitha furnizimeve dhe punimeve është 60 ditë, pas dates së nënshkrimit të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);  
Plani për menaxhimin e kontratës  
Proçesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyresi

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

1.12

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.





4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

**Komuna e Istogut:**

**Për Kontraktuesin:**

**Sh.p.k "EJONA"**

<b>Emri:</b>	Zizë Bujupaj	<b>Emri:</b>	Hysni Prelvukaj
<b>Pozita:</b>	Zyrtar përgjegjës i Prokurimit	<b>Pozita:</b>	D r e j t o r
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	24.04.2019	<b>Data:</b>	24.04.2019
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

Numri i Prokurimit: 633-19-607-1-2-1—633/19/011/121 – Titulli: PAISJA E OBJEKTIT  
KOMUNAL ME LIFT AUTOMATIK

**SHËNIM**

**Pjesa C:** - Formulari i Dorëzimit të Ofertës – ky formularë duhet të përdoret vetëm nëse tenderi dorëzohet në kopje fizike. Përndryshe, në qoftë se tenderi dorëzohet në mënyrë elektronike, formulari krijohet përmes sistemit.

**PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT**

**Pjesa I. Formulari i Tenderit**

Për: KOMUNA E ISTOGUT

(në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i kontratës: : PAISJA E OBJEKTIT KOMUNAL ME LIFT AUTOMATIK

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: 633-19-607-1-2-1—633/19/011/121 . Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:
3. Çmimi total i tenderit është:

Çmimi i tenderit në shifra: **24,824.84 €**

Dhe në fjalë: Njëzet e katërmijë e tetëqind e njëzet e katër Euro, e tetëdhjetë e katër cent



4. Ky tender është valid për një periudhë prej **60 ditë** nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës **10%** .
6. Operatori Ekonomik **EJONA SH.P.K** kanë këtë nacionalitet: **SHQIPTARË TË KOSOVËS** .
7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet, me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër

Në rast të konsorciumit



KOMUNA E ISTOGUT					
BLERJA DHE MONTIMI I ASHENSORIT					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Nr	Specifikimi i punëve	Njësi a (1)	Sasi a (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)

1	Blerja dhe montimi i ashensorit në KK Istog				
1.11	<p>TIPI: Ashensor Elektrik MRL</p> <p><b>Karakteristikat e ashensorit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kapaciteti 600kg/ 8 persona;</li> <li>- Shpejtësia 1.0 m/s;</li> <li>- Distanca e udhëtimit 11.60 m;</li> <li>- Stacionet/dyert 3 stacione ( 0,1,2);</li> <li>- Sistemi i levizjes elektrik MRL;</li> <li>- Me sistem VVVF;</li> <li>- Emergjencia në rastë të ndaljes së energjis elektrike;</li> <li>- Sistemi kontrollit i vendosur në katin e fundit...</li> </ul> <p><b>Dyert:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- teleskopike- materiali Inox.</li> </ul> <p><b>Dimenzionet e dyerve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjerësia 800x2000 mm, Qëndrore Inox</li> <li>- Butonat: Inox në kabin dhe jashtë me tregus posht lartë dhe me nr në çdo katë,</li> <li>- Ekran LCD me shigjeta treguese të kateve vendosen pranë derës,</li> </ul> <p><b>Karakteristikat e kabinës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Modeli INOKS- përgjithet nga Investitori, sipas standardeve T.S.E.K, me konstrukcion të çelikut EN81, me një hyrje (prodhim special i perforcuar) muret e përveshur me Inox të dizajnuar;</li> <li>- Tavani te ketë ndriqim indirect LED dhe të mjaftueshem;</li> <li>- Alarm i mbipeshes;</li> <li>- Ventilator. Interfon,</li> </ul> <p><b>Dimenzionet e gropes-kafazit: 2000x1600 mm;</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lartësia e katit të fundit 3800 mm;</li> <li>- Fundi i gropes maksimum 1000mm</li> </ul> <p><b>Dimenzionet e kabinës: Standard EN për 8 persona</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lartësia 2200 (TSE-863 dhe EN81-1).</li> </ul> <p><b>Shinat 70x65x9 mm 50x50x5</b></p>	copë	1	14,584.00	14,584.00 ✓
1.12	Furnizimi i kabllit 5x4 mm dhe lidhja n/ kutin kryesore të siguresave	m	44	4.00	176.00 ✓
1.13	Ndriqimi i kafazit të ashensorit sipas rregullores së ashensorve	paush	1	77.00	77.00 ✓
1.14	Material shpenzur për furnizim me elektrik, siguresa, kanalefa etj	paush	1	120.00	120.00 ✓
1.15	Çertifikimi nga kompania e licencuar për përdorimin e ashensorit	copë	1	240.00	240.00 ✓
2.1	<b>PUNET NDERTIMORE</b>				
2.11	Prerja e pllakes poshtë, thellësia 1.4 m	m/l	10	50.00	500.00 ✓
2.12	Thellimi i gropes së pastert	m3	7	40.00	280.00 ✓
2.13	Armimi me armatur fi 12mm i pllakes nalt, poshtë dhe anash	kg	380	0.70	266.00 ✓
2.14	Betonimi anash dhe posht me trashsi 20 cm	m3	3.5	55.00	192.50 ✓
2.15	Ankera fi16 mmx 4 fiqe	copë	4	12.00	48.00 ✓
2.16	Hidroizolimi nga ujrat nentoksor,	m2	19	6.50	123.50 ✓
2.17	Prerja e hidroizolimit dhe pregaditja për prerjen e pllakes në kulm;	paush	1	30.00	30.00 ✓
2.18	Prerja e pllakes nalt në kulm për pjesen kafazit që del mbi kulm;	m/l	9	30.00	270.00 ✓



Nr	Specifikimi i punëve	Njësi a (1)	Sasi a (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
2.19	Pregaditja kunder të reshurave deri sa të kryhen punimet- damet eventuali i ngarkohen punëkryesit	paush	1	80.00	80.00
2.20	Termoizolimi dhe qitja e fasades së murit;	m2	10	12.00	120.00
2.21	Muratimi dhe ngritja për 1 m e kafazit mbi kulm;	m2	10	20.00	200.00
2.22	Betonimi i kulmit të kafazit me trashsi 15 cm	m3	1.2	65.00	78.00
2.23	Termoizolimi dhe hidroizolimi i pllakes mbi kafaz;	m2	6	10.00	60.00
2.24	Hidroizolimi dhe lidhja e me hidroizolimin e kulmit	m2	14	10.00	140.00
2.25	Lidhja e pragjeve të ashensorit me granit sipas kërkeses së inves.	copë	3	40.00	120.00
2.26	Lyerja dhe sanimi i dameve të shkaktuara gjatë punimeve ndert.	paush	1	150.00	150.00
2.27	Rregullimi i keramikës dhe granitit në vendet e damtuara	m2	8	12.00	96.00
2.28	Material tjetër i nevojshëm për punet e betonit	paush	1	120.00	120.00
<b>3.1</b>	<b>PUNIMI I KAFAZIT TË ASHENSORIT</b>				
3.11	Kutia 100x100x4 mm	m	122	10.00	1,220.00
3.12	Kutia 100x 60x4 mm	m	48	5.00	240.00
3.13	Ngjyrosja e konstruksioni me ngjyr antikoroze dhe me ngjyr llak	m/l	170	0.90	153.00
3.14	Panel nga druri 20 mm me ngjyr sipas kërkeses së investitorit	m2	120	7.00	840.00
3.15	L llajsne për kande	m	48	1.50	72.00
3.16	T llajsne për lidhjen e paneleve	m	88	1.50	132.00
3.17	Material harxhus rreth punes së konstruksionit (elektroda, bulonaetj)	paush	1	200.00	200.00
3.18	Material harxhus rreth punes së mveshjes me panel	paush	1	110.00	110.00
<b>TOTALI PA TVSH</b>					<b>21,038.00</b>
					<b>TVSH</b>
					<b>3,786.84</b>
<b>TOTALI ME TVSH</b>					<b>24,824.84</b>



*[Handwritten signature]*  
*[Handwritten signature]*

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

~~Modifikimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës në shënime të forta të përmendura për nën-përkatëset e KPK. Për tani ato jo relevante.~~

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<i>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë</i>
	2.2	<i>Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe dhe gjuha serbe</i>
Siguria e ekzekutimit	9.1	<i>Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës, për periudhën prej 90 ditësh.</i>
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>Të gjitha furnizimet duhet të jenë të cilësisë së lartë. Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas furnizimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimeve janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë. Kontraktori obligohet që ta bëjë mbikqyrjen dhe funksionalizimin e paisjes në fjalë deri në funksionalizimin e plote të tijë.</i>
Pagesa	20.1	<i>Pagesa do të bëhet pas furnizimit dhe montimit të paisjes.</i>
Dorëzimi	21.3	<i>Dorëzimi i furnizimeve duhet të bëhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<i>Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 30.1.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.</i>